ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA HANI I ELEZIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **659-26-7013-2-3-6**

Sa i përket tenderit për **Sherbime te fotografimit, videoincizimit, xhirimeve me dron dhe pajisje per ruajtjen e te dhenave per Zyrene Kryetarit dhe DKRS-se**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**Pattern SH.P.K.**
NUI	**811976903**
Adresa	**Rruga Ruzhdi Shabani, nr 47**
Vendi	**Lipjan**
Kodi postar	**14000**
Numri Telefonit	**049570110**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Egzon Rizani**
Adresa elektronike	**patternshpk@yahoo.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**09.11.2026**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Sherbime te fotografimit, videoincizimit, xhirimeve me dron dhe pajisje per ruajtjen e te dhenave per Zyrene Kryetarit dhe DKRS-se

Aktiviteti i prokurimit nr. 659-26-7013-2-3-6, me titull "Shërbime të fotografimit, videoincizimit, xhirimeve me dron dhe pajisje për ruajtjen e të dhënave për Zyrën e Kryetarit dhe DKRS-së", është zhvilluar nga Autoriteti Kontraktues – Komuna Hani i Elezit, përmes procedurës së kuotimit të çmimit, me vlerë të parashikuar prej 9,935.00 € dhe kriter për dhënien e kontratës çmimin më të ulët të tenderit të përgjegjshëm.

Afati për dorëzimin dhe hapjen e ofertave ka qenë 25.09.2026, ora 13:00.

PATTERN SH.P.K. ka ofertuar 8,862.00 €, ndërsa me Njoftimin mbi Vendimin e AK-së, të datës 19.10.2026, është eliminuar, duke u rekomanduar për kontratë operatori Muhamet Dernjani B.I., me ofertë 8,930.00 €.

Më 25.10.2026, PATTERN SH.P.K. ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim. Me Vendimin nr. 02/2026, të datës 28.10.2026, AK e ka pranuar pjesërisht kërkesën dhe ka vendosur ta kthejë aktivitetin në rivlerësim, pa dhënë arsyetim konkret për të gjitha pretendimet ankimore.

PATTERN SH.P.K. e konteston vendimin për shkak të mosshqyrtimit të plotë të pretendimeve dhe arsyetimit të pamjaftueshëm lidhur me eliminimin e ofertës sonë dhe përgjegjshmërinë e operatorit të rekomanduar.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo ☐**

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

PATTERN SH.P.K., më datë 25.10.2026, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues – Komuna Hani i Elezit, sipas nenit 108/A të LPP-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit nr. 659-26-7013-2-3-6.

Në kërkesën për rishqyrtim kemi kundërshtuar eliminimin e ofertës sonë për mungesë të pretenduar të dëshmive të mjeteve të punës, si dhe kemi kontestuar përmbushjen e kriterit të përvojës së ngjashme prej 10,000.00 € nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, Muhamet Dernjani B.I.

Autoriteti Kontraktues, përmes Vendimit nr. 02/2026, të datës 28.10.2026, e ka pranuar pjesërisht kërkesën dhe ka njoftuar se do të bëjë rivlerësimin e tenderit.

Megjithatë, në arsyetimin e vendimit, AK i ka konsideruar pretendimet të pabazuara, pa ofruar përgjigje konkrete për mospërputhjet e identifikuara në referencat dhe kontratat e operatorit të rekomanduar dhe pa sqaruar cilat dëshmi mungojnë nga dokumentacioni i PATTERN SH.P.K.

Për këtë arsye, duke qenë të pakënaqur me trajtimin e kërkesës për rishqyrtim, paraqesim ankesë pranë OSHP-së.

Në mbështetje të kësaj ankese janë bashkëngjitur Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 19.10.2026, Kërkesa për Rishqyrtim e PATTERN SH.P.K. e datës 25.10.2026 dhe Vendimi i Autoritetit Kontraktues nr. 02/2026 i datës 28.10.2026 mbi kërkesën për rishqyrtim.

Gjithashtu, janë bashkëngjitur dokumentet mbështetëse të ofertës së PATTERN SH.P.K., përfshirë listën e mjeteve të punës dhe marrëveshjen e qirasë, si dhe dokumentacioni lidhur me kontratat, referencat dhe përvojën profesionale të operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, Muhamet Dernjani B.I.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Operatori Ekonomik PATTERN SH.P.K. konsideron se Autoriteti Kontraktues – Komuna

Hani i Elezit, gjatë ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertave, si dhe gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim të datës 25.10.2026, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e mëposhtme:

I. Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar:

Neni 7, paragrafët 1 dhe 2 – Barazia në Trajtim/Jodiskriminimi: Për shkak të trajtimit të pretenduar të pabarabartë të operatorëve ekonomikë, duke eliminuar ofertën e PATTERN SH.P.K. për mungesë të pretenduar të dëshmive, ndërsa për operatorin e rekomanduar nuk janë trajtuar konkretisht mospërputhjet e identifikuara në dokumentacionin e përvojës profesionale.

Neni 59, paragrafët 2 dhe 4 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve: Për shkak të vlerësimit të kontestuar të dokumentacionit të PATTERN SH.P.K. dhe mungesës së arsyetimit për përmbushjen e kritereve nga operatori i rekomanduar.

Neni 69 – Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale: Për shkak të mosvlerësimit të arsyetuar të listës së pajisjeve dhe marrëveshjes së qirasë së PATTERN SH.P.K., si dhe dyshimeve mbi përmbushjen e kriterit minimal prej 10,000.00 € për projekte të ngjashme nga operatori i rekomanduar.

Neni 72 – Dokumentacioni dhe Informacioni Shtesë: Lidhur me trajtimin e paqartësive të dokumentacionit të dorëzuar dhe mundësinë e kërkimit të sqarimeve, brenda kufizimeve të përcaktuara me ligj, pa ndryshuar materialisht ofertën.

Neni 108/A – Procedura e rishqyrtimit pranë Autoritetit Kontraktues: Për shkak të mosdhënies së përgjigjes konkrete dhe të arsyetuar për secilin pretendim të paraqitur në kërkesën për rishqyrtim.

II. Rregullorja Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, me ndryshimet dhe plotësimet e zbatueshme:

Neni 38 – Sqarimi i Tenderëve: Lidhur me trajtimin e paqartësive dhe dokumenteve të paraqitura gjatë vlerësimit.

Neni 40.2 – Ekzaminimi dhe vlerësimi: Për shkak të detyrimit për zbatimin e kritereve të përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit, pa shtuar ose ndryshuar kërkesa gjatë vlerësimit.

Neni 40.6, pikat a, b dhe c – Përgjegjshmëria e tenderit: Lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë administrative, teknike dhe përmbushjes së kritereve të përzgjedhjes.

Neni 40.7 – Përputhshmëria administrative dhe teknike: Lidhur me dallimin ndërmjet mangësive thelbësore dhe jothelbësore gjatë vlerësimit të ofertave.

Neni 40.8 – Sqarimi i tenderëve: Lidhur me zbatimin e procedurave të sqarimit gjatë ekzaminimit dhe vlerësimit.

III. Kundërthëniet në Vendimin nr. 02/2026, datë 28.10.2026

Autoriteti Kontraktues në dispozitivin e vendimit e ka pranuar pjesërisht kërkesën e PATTERN SH.P.K., ndërsa në arsyetim i ka cilësuar pretendimet ankimore të pabazuara dhe ka deklaruar se nuk ka bërë shkelje të LPP-së.

Pavarësisht këtyre konstatimeve, AK ka vendosur që aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim, pa identifikuar pretendimet e pranuara dhe pa dhënë arsyetim konkret për refuzimin e pretendimeve të tjera.

Në veçanti, AK nuk ka trajtuar mospërputhjet e identifikuara në listën e kontratave të operatorit të rekomanduar, natyrën e kontratave të deklaruara, vlerat e tyre dhe dëshmitë e realizimit.

Konsiderojmë se këto veprime dhe mangësi të arsyetimit kërkojnë shqyrtim nga OSHP, në përputhje me dispozitat e lartcekura dhe provat e paraqitura në kërkesën fillestare për rishqyrtim.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

MOSSHQYRTIMI I PLOTË DHE I ARSYETUAR I KËRKESËS PËR RISHQYRTIM

PATTERN SH.P.K., më 25.10.2026, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues – Komuna Hani i Elezit, lidhur me aktivitetin e prokurimit nr. 659-26-7013-2-3-6.

Në kërkesën për rishqyrtim kemi paraqitur pretendime konkrete lidhur me eliminimin e ofertës sonë për mungesë të pretenduar të dëshmive për mjetet e punës, si dhe për mospërmbushjen e kriterit minimal prej 10,000.00 € për projekte të ngjashme nga operatori i rekomanduar për kontratë, Muhamet Dernjani B.I.

Me Vendimin nr. 02/2026 të datës 28.10.2026, Autoriteti Kontraktues ka vendosur që kërkesa jonë të pranohet pjesërisht.

Megjithatë, në arsyetimin e vendimit, AK deklaron se të gjitha pretendimet ankimore janë

të pabazuara dhe se nuk ka bërë asnjë shkelje të Ligjit për Prokurimin Publik.

Pavarësisht këtyre konstatimeve, në përfundim të vendimit AK njofton se do të bëjë rivlerësimin e tenderit.

Ky arsyetim është kundërthënës, pasi nuk identifikon cilat pretendime janë pranuar, cilat janë refuzuar dhe mbi çfarë baze faktike dhe juridike është vendosur rivlerësimi.

AK nuk ka trajtuar individualisht pretendimet tona për mospërputhjet e referencave të operatorit të rekomanduar, vlerën minimale të përvojës, kontratat jashtë periudhës së kërkuar dhe vlerat e kontratave kornizë.

Konsiderojmë se vendimi nuk ofron arsyetim të mjaftueshëm për të vlerësuar ligjshmërinë e shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim.

Kërkojmë nga OSHP që të konstatojë mangësitë në arsyetimin e Vendimit nr. 02/2026 dhe të urdhërojë trajtimin e plotë dhe të arsyetuar të pretendimeve tona, në përputhje me dispozitat e LPP-së.

ELIMINIMI I KONTESTUAR I PATTERN SH.P.K. PËR DËSHMITË E MJETEVE TË PUNËS

Në pikën III.4 të Dosjes së Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që operatori ekonomik të dëshmojë disponueshmërinë e minimum dy kamerave dhe një droni.

Për këtë qëllim, AK ka kërkuar listën e mjeteve të punës, të nënshkruar dhe vulosur, faturat e blerjes për pajisjet në pronësi ose marrëveshje qiraje nëse pajisjet nuk janë në pronësi të operatorit ekonomik.

PATTERN SH.P.K., në ofertën e dorëzuar më 25.09.2026, ka paraqitur dokumentin “5. Lista e Mjeteve te punes.pdf”, të nënshkruar dhe vulosur, ku janë deklaruar dy kamera profesionale dhe dy dronë profesionalë.

Gjithashtu është dorëzuar dokumenti “6.Marreveshje qiraje pajisjeve.pdf”, i lidhur më 24.09.2026 ndërmjet PATTERN SH.P.K. dhe EVENT PRODUCTION STUDIO.

Marrëveshja identifikon shprehimisht aktivitetin e prokurimit nr. 659-26-7013-2-3-6, përcakton pajisjet dhe sasitë e tyre, garanton disponueshmërinë gjatë realizimit të projektit dhe është nënshkruar e vulosur nga të dyja palët.

Në Vendimin nr. 02/2026, AK pretendon se marrëveshjes i mungojnë dëshmitë e nevojshme, mirëpo nuk identifikon asnjë kërkesë konkrete të Dosjes së Tenderit që nuk është përmbushur.

AK nuk sqaron se cili dokument mungon, cili element i marrëveshjes është i

papranueshëm dhe për çfarë arsye dokumentacioni i dorëzuar nuk përmbush kriterin e publikuar.

Konsiderojmë se një konstatim i përgjithshëm për mungesë dëshmish, pa identifikuar mospërputhjen konkrete me Dosjen e Tenderit, nuk përbën arsyetim të mjaftueshëm për eliminimin e operatorit ekonomik.

Kërkojmë nga OSHP që të shqyrtojë dokumentacionin e dorëzuar dhe të konstatojë nëse Autoriteti Kontraktues e ka vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme kriterin e mjeteve të punës, në përputhje me nenet 7, 59 dhe 69 të LPP-së.

MOSSHQYRTIMI I MOSPËRPUTHJEVE NË DOKUMENTACIONIN E OPERATORIT TË REKOMANDUAR

Në kërkesën tonë fillestare për rishqyrtim kemi kontestuar përmbushjen e kriterit minimal prej 10,000.00 € për projekte të ngjashme dhe të realizuara me sukses nga operatori ekonomik Muhamet Dernjani B.I.

Sipas pikës III.4 të Dosjes së Tenderit, operatori ekonomik duhet të dëshmojë përvojë në realizimin e projekteve të ngjashme gjatë tri viteve të fundit nga publikimi i Njoftimit për Kontratë.

Në dokumentacionin e operatorit të rekomanduar janë identifikuar mospërputhjet në vijim:

1. Kontratat jashtë periudhës së kërkuar

Referenca e datës 28.05.2025 përmban kontrata të përfunduara më 28.04.2023 dhe 09.07.2023, përpara fillimit të periudhës trevjeçare të përcaktuar në kërkesën për rishqyrtim.

2. Kontratat jo të ngjashme

Në listën e kontratave janë përfshirë edhe furnizime me kabllo, notesa, kalendarë dhe artikuj të tjerë, për të cilat nuk është arsyetuar ngjashmëria me shërbimet e fotografimit, videoincizimit dhe xhirimeve me dron.

3. Mospërputhja e vlerës 6,628.50 €

Operatori i rekomanduar ka deklaruar për Lotin 2 të aktivitetit nr. 659-25-10378-1-3-6 vlerën prej 6,628.50 €.

Ndërkaq, sipas Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, datë 12.12.2025, vlerat janë:

Loti 1: 2,100.00 €.

Loti 2: 2,063.50 €.
Loti 3: 2,465.00 €.

Shuma 6,628.50 € përfaqëson totalin e tre loteve dhe jo vetëm vlerën e Lotit 2.

4. Kontratat kornizë

Në kërkesën për rishqyrtim kemi kërkuar verifikimin e realizimit faktik të kontratave kornizë, pasi vlera e kontraktuar nuk dëshmon automatikisht vlerën e shërbimeve të realizuara dhe të pranuara.

5. Përllogaritja e përvojës së ngjashme

Nga dokumentacioni i shqyrtuar kemi identifikuar përvojë qartësisht të ngjashme në vlerë 5,891.20 €, ndërsa duke përfshirë edhe Lotin 1 të vitit 2025, vlera arrin në 7,871.20 €, që është 2,128.80 € nën minimumin e kërkuar prej 10,000.00 €.

Kjo është përllogaritja e ankuesit dhe kërkon verifikim nga organi kompetent mbi bazën e dokumentacionit të plotë.

Pavarësisht paraqitjes së këtyre fakteve në kërkesën e datës 25.10.2026, Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë përgjigje konkrete lidhur me to në Vendimin nr. 02/2026.

Kërkojmë nga OSHP që të shqyrtojë pretendimet e paraqitura dhe të verifikojë nëse operatori i rekomanduar i plotëson kërkesat minimale për përvojën e ngjashme sipas Dosjes së Tenderit dhe nenit 69 të LPP-së.

TRAJTIMI I PABARABARTË I OPERATORËVE EKONOMIKË DHE NDIKIMI NË REZULTATIN E PROKURIMIT

PATTERN SH.P.K. konsideron se Autoriteti Kontraktues nuk ka dëshmuar zbatimin e standardeve të njëjta të vlerësimit ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë.

Oferta jonë është eliminuar për mungesë të pretenduar të dokumentacionit për mjetet e punës, megjithëse janë dorëzuar lista e mjeteve dhe marrëveshja e qirasë.

Në anën tjetër, operatori Muhamet Dernjani B.I. është rekomanduar për kontratë, përkundër mospërputhjeve të identifikuara nga ankuesi lidhur me natyrën, periudhën, vlerën dhe realizimin e kontratave të deklaruara si përvojë e ngjashme.

AK nuk ka dhënë përgjigje konkrete për këto pretendime në vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim.

PATTERN SH.P.K. ka ofertuar 8,862.00 €, ndërsa operatori i rekomanduar ka ofertuar

8,930.00 €.

Oferta jonë është 68.00 € më e ulët.

Duke qenë se kriteri për dhënien e kontratës është çmimi më i ulët i tenderit të përgjegjshëm, vlerësimi i kontestuar mund të ndikojë drejtpërdrejt në rezultatin e aktivitetit të prokurimit.

Kërkojmë nga OSHP që të shqyrtojë respektimin e nenit 7 dhe nenit 59 të LPP-së dhe, nëse konstatohen shkelje, të urdhërojë masat e nevojshme korrigjuese për rivlerësim të ligjshëm, të barabartë dhe të arsyetuar të ofertave.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

****8. DËMET MATERIALE****

Si pasojë e eliminimit të kontestuar të ofertës sonë dhe mosshqyrtimit të plotë dhe të arsyetuar të pretendimeve ankimore nga Autoriteti Kontraktues – Komuna Hani i Elezit, PATTERN SH.P.K. është cenuar në të drejtën për konkurrim të drejtë dhe të barabartë, duke rrezikuar humbjen e mundësisë për t'u shpërblyer me kontratë.

PATTERN SH.P.K. ka dorëzuar ofertën në vlerë prej 8,862.00 €, ndërsa operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, Muhamet Dernjani B.I., ka ofertuar 8,930.00 €. Oferta jonë është 68.00 € më e ulët, ndërsa kriteri për dhënien e kontratës është çmimi më i ulët i tenderit të përgjegjshëm.

Eliminimi i kontestuar i ofertës sonë, si dhe mungesa e trajtimit konkret të pretendimeve lidhur me përgjegjshmërinë e operatorit të rekomanduar, rrezikojnë t'i shkaktojnë PATTERN SH.P.K. dëme materiale, përfshirë humbjen e mundësisë për realizimin e kontratës, fitimin e pritshëm nga ekzekutimi i saj dhe shpenzimet e lidhura me përgatitjen e ofertës dhe ndjekjen e procedurave ankimore.

Dëmi i pretenduar lidhet me humbjen e mundësisë për t'u vlerësuar në mënyrë të ligjshme dhe të barabartë, duke marrë parasysh se oferta jonë është financiarisht më e favorshme se oferta e operatorit të rekomanduar, nëse konfirmohet përgjegjshmëria e saj.

Përmes kësaj ankese kërkojmë konstatimin dhe korrigjimin e shkeljeve të pretenduara, shqyrtimin e plotë të dokumentacionit dhe rivlerësimin e ligjshëm të ofertave, me qëllim që PATTERN SH.P.K. të mos privohet nga mundësia për t'u shpërblyer me kontratë, nëse konfirmohet përgjegjshmëria e ofertës sonë.

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*